



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:148359

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05442136

2022:220933

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, punëtore e kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të pandehurit E.K nga fsh....-Kaçanik, për vepër penale, Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II/nr. 68/22 të datës 20.10.2022, duke vendosur sipas kërkesës së të pandehurit, të ushtruar përmes mbrojtësit të tij me autorizim av.Fitim Shabani, me të cilën ka kërkuar hudhjen e aktakuzës, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me dt. 07.02.2024 merr këtë ,

A K T V E N D I M

APROVOHET kërkesa për hudhjen e aktakuzës , e parashtruar nga I pandehuri E.K përmes mbrojtësit me autorizim, av. Fitim Shabani, si e bazuar.

HUDHET aktakuza e prokurorisë Themelore Ferizaj PP.II/nr.68/22 të datës 20.10.2022 dhe pushon procedura penale ndaj të pandehurit E.K nga fsh....-Kaçanik, për vepër penale, Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj, ka parashtruar aktakuzën PP.II/nr 68/22 të datës 20.10.2022 kundër të pandehurit, E.K nga fsh....-Kaçanik, për veprë penale, Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Ne bazë të kësaj aktakuze gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar më dt. 21.11.2023 me të cilin rast, pas prezentimit të aktakuzës nga prokurori i shtetit Ardian Emini, i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata e ka udhëzuar të pandehurin, se konform nenit 243 dhe 244 të KPP-së, mund të paraqesë kundërshtim për provat e cekura në aktakuzë, dhe kërkesë për hudhjen e aktakuzës në pajtim me dispozitat e lartëcekura.

I pandehuri E.K, përmes mbrojtësit të tij të autorizuar, av.Fitim Shabani, në afatin e paraparë nga gjykata, ka parashtruar pranë kësaj gjykate, kërkesën për hudhje të aktakuzes, përmes së cilës ka kërkuar nga gjykata që të nxjerr aktvendim për hudhje të aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj, me arsyetimin se në veprimet e të mbrojturit të tij, nuk formësohen elementet e veprës penale, për të cilën akuzohet.

Gjykata e njoftoi Prokurorinë me kërkesën e të pandehurit, dhe kjo e fundit në afatin e paraparë ligjor nuk ka prezentuar ndonjë përgjigje me shkrim.

Në rastin konkret, gjykata, me rastin e shqyrtimit të kërkesës për hudhjen e aktakuzës, bazuar në shkresat e lëndës, fillimisht ka verejtur, se I pandehuri si përfaqësues i Kompanisë “2 Korriku” Shpk, bazuar në Ligjin Nr.03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,(ligj në fuqi në kohën për të cilën bëhet fjalë) neni 20 par.2 nënpar.2.2, ka përmbushur obligimin e tij ligjor duke informuar publikun përmes mjeteve të informimit, duke shpallur njoftimin për debat publik në gazetën ditore, Epoka e Re me dt. 08 Dhjetor 2020, përmes së cilit publiku është njoftuar për datën, lokacionin, kohën e mbajtjes së debatit public dhe dokumentet e parapara për debat, në rastin konkret, raporti I VNM-së për kompaninë “2 Korriku “Shpk, ... Kaçanik, për ndryshimin e kapacitetit nga 1.3 MW në 3.75 MW të hidrocentralit në lumin Lepenc-Komuna Kaçanik.

Poashtu gjykata, bazuar në shkresat e lëndës, ka vërejtur se I pandehuri, me dt.09 Dhjetor 2020, e ka njoftuar përmes email-it ejupkovaqi@hotmail.com, zyrtaren komunale, Fatlume Selimi me email zyrtar, fatlume.selimi@rks-gov.net, duke I dorëzuar konfirmimin për debat public, dhe njoftimin për debat public dhe linkun me Raportin e VNM-së, për kompaninë “2 Korriku” Shpk, ... Kaçanik, për ndryshimin e kapacitetit nga 1.3 MW në 3.75 MW të hidrocentralit në lumin Lepenc-Komuna Kaçanik. Ky njoftim, bazuar në fotografitë e tabelës së shpalljeve të Komunës së Kaçanikut, është publikuar në tabelën e shpalljeve të kësaj komune, duke u përmbushur, kështu edhe udhëzimi I zyrtares Malsore Jonuzi, zyrtare për VNM, në Divizionin për Menaxhimin e Ndotjes Industriale në kuadër të Departamentit të Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, I parashtruar përmes email-it zyrtar, Malsore.Jonuzi@rks-gov.net, të dt.03 Dhjetor 2020.

Prokuroria Themelore në Ferizaj, përmes aktakuzës në fjalë pretendon se, I pandehuri E.K, si përfaqësues I kompanisë “2 Korriku”Shpk, ka përdorur document të falsifikuar zyrtar, të njoftimit për debat public në Web faqen zyrtare të Komunës së Kaçanikut, të datave 11.12.2020 dhe 30.12.2020 me rastin e kompletimit të dokumentacionit, për të marrë pëlqimin lidhur me ndryshimin e kapacitetit të hidrocentralit në lumin Lepenc, Komuna e Kaçanikut, nga 1.3 MW në 3.75 MW, prandaj edhe e ka aukzuar për veprën penale, Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Dispozita ligjore e nenit 390 par.1 të KPRK-së, e cila rregullon formën themelore të kësaj vepre, veprën penale, Falsifikim I dokumenteve, e përshkruan si në vijim, “ Kushdo që përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër (4) vjet”.

Derisa në paragrafin 2 të nenit 390 të KPRK-së, është paraparë forma e kualifikuar e kësaj vepre penale, bazuar në llojin e dokumentit që është objekt I falsifikimit, ku për t’u përmbushur elementet e formës së kualifikuar të kësaj vepre penale, dokumenti I falsifikuar duhet të jetë dokumnet publik.

Gjykata me rastin e analizimit të veprës penale për të cilën është akuzuar I pandehuri, vlerëson se për t’u përmbushur elementet e kësaj vepre penale, duhet që I pandehuri të ketë përdorur

dokumentin public të falsifikuar, përkatësisht të ketë përdorur dokumentin public të rremë apo të ndryshuar si të vërtetë në raport me personin të cilit I është adresuar.

Rrjedhimisht në rastin konkret, për t'u përmbushur elementet e veprës penale, Falsifikim I dokumenteve nga neni 390 par.2 të KPRK-së, njoftimi zyrtar për debat public duhet të ketë qenë I falsifikuar, dhe pastaj I njejtë të përdoret nga I pandehuri për të kompletuar dokumentacionin, në rastin konkret, lidhur me ndryshimin e kapacitetit të hidrocentralit në lumin Lepenc, Komuna e Kaçanikut, nga 1.3 MW në 3.75 MW.

Bazuar në shkresat e lëndës, njoftimi për debat public në asnjë rast nuk kontestohet si I falsifikuar, bazuar në formën siq e rregullon ligji, por trajtohet në formën që I pandehuri nuk ka paraqitur kërkesë zyrtare në Komunën e Kaçanikut për publikimin në tabelën e shpalljeve, të njoftimit për debat public, derisa ka përdorur njoftimin në fjalë, para organeve kompetente me rastin e kompletimit të dokumentacionin, për arsyen e cekur më lartë.

Kjo sipas gjykatës është çështje që rregullohet me procedurë administrative, pra forma e paraqitjes së kërkesës për publikimin e njoftimit për debat public, por që relevante në rastin konkret është që gjykata të konstatojë nëse njoftimi për debat public si document, ka qenë ose jo I falsifikuar, e pastaj nëse I njejtë është përdorur nga I pandehuri, para organeve kompetente, për të kompletuar dokumentacionin, lidhur me ndryshimin e kapacitetit të hidrocentralit në lumin Lepenc, Komuna e Kaçanikut, nga 1.3 MW në 3.75 MW.

Gjykata, bazuar në njoftimin për debat public të publikuar në Gazetën Ditore, “ Epoka e Re” me dt. 08 Dhjetor 2020, vërejtë se I njejtë është bërë conform nenit 20 par.2 nënpar.2.2 të Ligjit Nr.03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,(ligj në fuqi në kohën për të cilën bëhet fjalë), me të cilin njoftim pastaj përmes email-it zyrtar është njoftuar edhe Fatlume Selimi, zyrtare komunale në Zyrën për Informim dhe Marëdhënie me publikun në Komunën e Kaçanikut.

Fakti që ky njoftim nuk është gjetur në faqen zyrtare të komunës së Kaçanikut, nuk nënkupton se I njejtë, pra njoftimi për debat public, ka qenë I falsifikuar, për shkak se për t'u konsideruar një document I falsifikuar duhet që dokumenti mos të rrjedh nga personi I cili është I shënuar në te si lëshues apo dhënës I tij, dhe me të njejtin tentohet që të krijohet përshtypja se pikërisht

personi I caktuar është lëshues apo dhënës I atij dokumenti, edhe në rastet kur përmbajtja e tij është e saktë, por siq u tha më lartë nuk është lëshuar nga personi I cili në dokument është shënuar si dhënësi apo lëshues I tij.

Bazuar në të gjitha të dhënat e rastit, duke qenë se lëshuesi I dokumentit-njoftimit për debat public, është kompania “2 Korriku” me përfaqësues të pandehurin, gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurit nuk ka elemente të veprës penale për të cilën akuzohet.

Prandaj bazuar në të lartëcekurat, dhe konfor nenit 248 par.1 nënpar.1.5 të KPP-së, gjykata hedh aktakuzën e Prokurorisë Themelore Ferizaj PP.II/nr.68/22 të datës 20.10.2022,dhe pushon procedurën penale kundër të pandehurit E.K nga fsh....-Kaçanik, për veprë penale, Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, pasi që vlerëson se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mire se I pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet me aktakuzë.

Nga sa u tha më lartë u vendos sin ë dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

2022:220933 datë 07.02.2024.

Gjyqtarja ,
Zajrete Muhaxheri

Këshilla juridike: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Kolegjit te Gjykeses se Apelit ne Prishtine permes kesaj gjykate.